



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Tiranë, me 05.10.2018

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit Nr. 173 datë 05.10.2018 “Për pranimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2018 – 2019, ne Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), që duke filluar nga data 05.10.2018 deri më 11.10.2018, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

Departamenti i Sportit

- Gjimnastikë (Bachelor) 1(një) As/ Lektor, Lektor

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shënuar qarte mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomën dhe Certifikatën e notave të studimeve Bachelor (fotokopje)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
- Certifikatën e gradës Doktor i Shkencave (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor (nqs ka) (fotokopje)
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punes per t’u angazhuar si pedagog i ftuar ne institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Drejtoria e Shëndetit Publik (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- Vërtetim nga qendra e punes per t’u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme ne institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Drejtoria e Shëndetit Publik (dorëzohet nëse shpallet fitues)

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të ketë përfunduar studimet pranë Universitetit të Sporteve (Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes) me kohë të plotë.

- Nota e mesatare e ciklit të parë të studimeve (Bachelor) duhet të jetë mbi 8-të;
- Të zotërojë nje gjuhë te huaj (preferohet gjuha angleze).
- Të ketë njohuri për njohjen e programeve bazë kompjuterike
- Të ketë së paku diplomën “Master i Shkencave”
- Kanë preferencë pedagogër më grada e tituj : Prof.Asc.Dr., Dr.
- Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të përputhet me lëndën mësimore që do të zhvillojnë sipas departamentit ku aplikon
- Preferohen pedagogët qe kanë pervoje në mësimdhënie në shkollën e lartë.
- Të kete veprimtari shkencore si: referime, botime, studime.
- Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar qe i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.

Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti ku konkuron, Departamenti, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail të konkurentit.

R E K T O R

Prof. Dr. Agron CUKA

Konceptoi: Specialiste: L. Shehu

Pranoi: Drejtore: F. Jasa

Miratoi: Administratore: M. Galushi

Numri i kopjeve origjinale : 3 (tre)